



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2020:001873

Datë: 07.03.2024

Numri i dokumentit: 05422721

PKR.nr.63/2023

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA**, trupi gjykues i përbërë gjyqtarët Artan Sejrani, kryetar i trupit gjykues, Kymete Kicaj dhe Lulzim Hoxha anëtarë, në çështjen penale ndaj të akuzuarit F. M., nga Fushë Kosova, për shkak të veprës penale kontrabandimi me migrantë nga neni 164 par.1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren PP/I.nr.4/2020 të datës 04.03.2020, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor publik, në prezencën e të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij B.A., në mungesë të Prokurorit të Shtetit Ervehe Gashi, me datën 09.02.2024 shpalli, ndërsa me datën 07.03.2024 përpiloi me shkrim këtë:

**AKTGJYKIM**

**I akuzuari:**

F. M., nga i ati ..... e ëma ....., e lindur ....., i lindur me datën ....., në Prishtinë, tani me vendbanim në Fushë Kosovë në rrugën '.....nr....., ka të kryer shkollën fillore, taksist, i gjendjes së dobët ekonomike, i martuar, me numër personal ....., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Në kuptim të nenit 363 par 1 nënparag. 1.3 të KPP-së:

**LIROHET NGA AKUZA**

Se me datë 07 Janar 2020, rreth ores 21:21 minuta në afersi të restorant "Jeta" në fshatin Vermicë, Komuna e Prizrenit, është hasur nga ana e Policisë se merret me kontrabandim të migrianteve e me qëllim të përfitimit të drejtpërdrejtë të dobisë pasurore, në atë mënyrë që gjatë patrullimit të Policisë Kufitare, Policia ka ndaluar automjetin ".....", me targa ....., të cilën ishte duke e drejtuar i pandehuri F. M., dhe është vërtetuar se i pandehuri transporton migrantët palestinez S.S., M.A.K., N.L., dhe A.L., të cilët ka pasur ti transportojë pas marreveshjes paraprake prej pikës kufitare Vermicë në qendrën e azilit për të huaj në Magurë, dhe për këtë shërbim nga secili prej tyre është dashur ti merr nga 20 euro.

**Këso dore kishte për të kryer veprën penale kontrabandim me migrantë nga neni 164 par.1 të KPRK-së.**

- Pasi që nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, në mbështetje të nenit 363 par. 1 nën. par. 1.3 të KPP-së.

- Automjeti i konfiskuar “.....”, me targa të regjistrimit ....., me numër të shasisë .....dhe Telefoni i llojit “Samsung J7” me numër të telefonisë “VALA” ....., pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, duhet ti kthehen të akuzuarit.

- Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

### **Arsyetim**

Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda pranë kësaj Gjykate ka parashtruar aktakuzën PP/I.nr.4/2020 të datës 04.03.2020, ndaj të akuzuarit F. M., nga Fushë Kosova, për shkak të veprës penale kontrabandimi me migrantë nga neni 164 par.1 të KPRK-së.

Në këtë çështje penale është mbajtur shqyrtimi gjyqësor publik, i akuzuari është deklaruar i pafajshëm, andaj gjykata i ka paraqitur provat gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Prokurori i Shtetit Ervehe Gashi në fjalën përfundimtare ka mbetur në tërësi pranë fjalës përfundimtare të datës 06.10.2022, në të cilën fjalë përfundimtare ndër të tjera ka theksuar se është vëretuar gjendja faktike e përshkruar sikurse në dispozitiv të aktakuzës, kjo gjendje faktike është vëretuar prej dëshmisë së të dëmturëve të marra në mundësinë hetuese të veçantë, raporti i ekspertizës së njësisë për ekzaminimin e pajisjeve të teknologjisë së informacionit, vëretimin mbi sekuestrimin e sendeve dhe pjesërisht nga deklarimi i të pandehurit F. M.,. Më gjerësisht ka bërë edhe përshkrimin e përmbajtës së provave ndërsa ka qëndruar edhe pranë kualifikimit ligjor të veprës penale. Në fund ka propozuar edhe marrjen e sendit - konfiskimin e automjetit dhe kthimin e telefonit tek i akuzuari.

Mbrojtësi i të akuzuarit avokat Sh.M., fjalën përfundimtare gjykatës ia ka parashtruar me shkrim, në të cilën ndër të tjera ka theksuar se sa i përket akuzës shpreh qëndrimin e tij se prokuroria nuk ka arritur që gjykatës ti ofrojë prova dhe ta bind se i akuzuari F. M., ka kryer veprën penale ashtu si që është përshkruar në dispozitivin e aktakuzës e aq më pak ashtu si janë cilësuar veprimet e tij. Pra, aktakuza është e pa qëndrueshme sa i përket gjendjes faktike dhe cilësimit juridik të veprës penale. Përshkrimi i gjendjes faktike në dispozitivin e aktakuzës nuk korespondon me provat e administruara në shqyrtimin kryesor apo ato të siguruara në fazën e hetimeve, përkundrazi në rrethanat kryesore, konstatimet në dispozitivin e aktakuzës nuk kanë mbështetje në provat e administruara e në anën tjetër në dispozitiv nuk janë theksuar faktet dhe rrethanat që pa asnjë dilem janë vertetuar me provat e administruara. Aktakuza është absolutisht e pa qëndrueshme dhe shumë kontraktitore me veprën për të cilën është akuzuar i akuzuari, andaj si e tillë nuk qëndron. I akuzuari akuzohet për kontrabandim me migrant, ndërsa përshkruhet që i njëjti vjen nga Prishtina në Prizren për të marrë dhe transportuar migrantët. I njëjti

akuzohet se me datën 07.01.2020 rreth orës 21:21 minuta, në afërsi të restoranti ".....", në fshatin Vërmicë, Komuna e Prizrenit, teritor ky i Republikës së Kosovës i merr migrantët në mënyrë që të njejtit do të duhet te i transportonte prej kësaj pike brenda teritorit të Republikës së Kosovës, prapë teritorit të Republikës së Kosovës pra në qendrën për azil për të huajin në Magure. Konstatimet tjera në dispozitivin e aktakuzës që kanë të bëjnë me ngjarjen e zhvilluar në mes të akuzuarit dhe personave tjerë, nuk përkojnë me konsumimin e veprës penale dhe nuk kanë mbështetje me provat e administruara. Shtrohet pyetja pse ndodhin kështu me këto konstatime të pa qarta, konfuze dhe në kundërshtim me provat e administruara? Nuk ka tjetër koment për veq faktit se vlerësimi i provave është vënë në mënyrë të një anshme, në dëm të të akuzuarit dhe në kundërshtim me nenin 7 parag. 1 dhe 2 të KPPK-së. Prokuroria vetëm ka bërë përshkrimin e veprës të inicuar sipas kallximit penal dhe të njejtën përkundër që nuk ka pasur mbështetje dhe fakte në tërësi kanë qendruar deri në fund. Si dëshmitarët gjithashtu edhe vetë policia asnjëherë nuk e kanë mohuar faktin që i akuzuari ka qenë taksist, dhe se ushtron profesionin e tij prej taksie për me shumë vite, në këtë kuptim edhe ka vepruar duke i marrë dhe transportuar të gjithë klientet e tij pa dallim gjinie, etnie, apo konfesionin. I njëjti ka vepruar njejtë edhe ditën kur është ndaluar nga policia e Kosovës, pra as nuk ka tentuar që të largohet apo të shmang ndalimin. Ka marrë qytetarët e shtetit Palestinez, të cilët vetë e kanë konfirmuar që të njejtit e kanë kaluar kufirin në format e tyre pa mdihmën e të akuzuarit, në asnjë rrethanë fakt ky i vërtetuar edhe nga vetë dëshmit e tyre, këtë gjë e ka vërtetuar edhe hetuesia me që asnjëherë nuk ka nxjerrë ndonjë konkludim tjetër pos qe duke thënë që i akuzuari i merr të njejtit në Vërmicë për në Qendren e Azilit në fshatin Magure. Duke marrë parasysh faktin që i akuzuari në momentin kur e ka ushtruar funksionin e taksistit ka qenë me leje të skaduar, leje kjo e cila është lëshuar nga Komuna e Fushë Kosovës, të vetmin veprim të cilin e ka kryer ka qenë kundërvajtje. Ndërkaq vepra e cila i vihet në barrë pra ajo e kontrabandimit me migrant nga neni 164 parag. 1 në asnjë rrethanë të vetme me veprimet të të akuzuarit nuk përmbushen elementet e kësaj vepre penale. Mëse miri këtë e spjegon komentari ku thotë për elementet e veprës penale duhet nënkuptuar veprimin i cili konsiston në transportimin e migrantëve, kuptohet në mënyrë ilegale, prej një shteti në shtetin tjetër. Duke pasur parasysh atë që u tha me lartë, konsideron se prokuroria nuk ka arritur të përmbush detyrimin i ligjor që gjykatës ti oforjë prova se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar dhe se për këtë është dhënë fakte të mjaftueshme gjykatës për vërtetimin e të kundërtes. Dëshmit që kanë të bëjnë me këtë akuzë gjykata duhet ti vlerësoj si të pa bazuara, me që të njejtat nuk përbëjnë veprën penale për të cilën është akuzuar i akuzuari dhe si të tilla nuk i përmbushin elementet e veprës penale kontrabandim me migrantë. Duke marrë parasysh edhe rekomandimet e gjykatës Supreme të Kosovës, shihet qartë që mungon dhe se nuk është vërtetuar asnjëherë elementi i ekzistimit të veprës penale, element ky i cili pos që nuk ka ekzistuar i njëjti asnjëherë nuk është vërtetuar por që i akuzuari është dënuar dhe shpallët fajtorë. Konsidern që keto fakte gjykata do ti merrë parasysh dhe duke u bazuar në rekomandimet dhe gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës por edhe në elaborimin tonë, për veprën për të cilën është akuzuar e dënuar i akuzuar do të merren për bazë dhe se do të bindet që i njëjti me veprimet e tija nuk ka konsumuar veprën për të cilën është akuzuar. Me që me provat e administruara nuk është vërtetuar ekzistimi i dyshimit mirë të besuar se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën është

akuzuar, kërkon që i njëjti konform nenit 363 parag. 1 nën parag. 1.3 të Lirohet nga akuza dhe të shpallët i pa fajshëm.

Gjykata ka vepruar sipas rekomandimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës, duke i administruar edhe njëherë të gjitha provat dhe atë leximi i deklaratave të dëmtuarëve të dhëna në cilësi të dëshmitarit S.O.S., N.L., M.A.K., A.L., të dhënë gjatë mundësisë hetuese të veçantë sipas procesverbalit Ppr.nr.3/2020 të datës 09.01.2020, leximi i raportit të ekspertizës i Drejtorisë Kriminalistike - sektori për fotografi, video analizë dhe ekzaminimeve të IT- Njësia për ekzamimin e pajisjes ë Teknologjisë së Informacionit, shqimi në fotodokumentacion, leximi i vëretimit mbi skeustrimin e përkohshëm me nr. 2020-YWC-001 të datës 07.01.2020.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor është bërë leximi i deklarimit të dëmtuarit - dëshmitarit S.O.S., e cila deklaratë është siguruar gjatë mundësisë hetuese të veçantë. Dëshmitari ka theksuar se deri afër kufirit me Republikën e Kosovës ka ardh me autobus më pas nëpër mal kanë ec 4 km dhe pastaj ka zbritur në rrugë dhe janë orientuar përmes GPRS. Gjatë kalimit të kufirit nuk i ka ndihmuar askush. Kontaktin me të akuzuarin e ka siguruar përmes një shokit të tij nga Kosova ku edhe ka kontaktuar me të akuzuarin F. dhe i akuzuari iu kishte thënë se "për një orë vi tek ju" dhe pas një ore ka ardh. Me të akuzuarin ka komunikuar përmes aplikacionit WhatsApp dhe në gjuhën angleze pasi që pak e njeh këtë gjuhë. Çmimin për transport, i akuzuari ka kërkuar shumën prej 100 Euro për 4 persona apo të dëmtuarit dhe të njëjtit i kanë thënë se nuk kanë mjete ndërsa i akuzuari ka pranuar që ti transportoj deri në kamp - rethinen e kampit të refugjatëve edhe pa të holla. I dëmtuari ka theksuar se për qëllim ka pasur që të kaloj në Serbi dhe Hungari pastaj në Evropë.

Duke analizuar dëshminë e të dëmtuarit dhënë në cilësi të dëshmitarit, gjykata nuk ka mundur të vërtetojë asnjë element të veprës penale, ku dëshmitari e ka përshkruar se si ka ardhur me autobus deri në pikën kufitare dhe përmes GPRS është orientuar dhe nëpër malë ka hy në Kosovë. Pra, me këtë dëshmi rezulton se i akuzuari nuk ka ndërmarr asnjë veprim lidhur me kalimin e kufirit, dëshmitari vetë ka ardhur në Kosovë pa ndihmën e askujt. Nga pika kufitare i akuzuari në cilësi të taksistit ka pasur për obligim të dërgojë deri tek qendra e azilit – kampi i refugjatëve. Pra, me këtë dëshmi kjo gjykatë nuk ka mundur ta vërtetojë asnjë element të veprës penale me të cilën ngarkohet i akuzuari.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor është lexuar edhe deklarimi i të dëmtuarit - dëshmitarit N.L., e cila deklaratë është siguruar përmes mundësisë hetuese të veçantë, në deklarimin e tij dëshmitari thekson se në Republikën e Kosovës kanë ardhë nga ana e Shqipërisë dhe se kufirin e kanë kaluar së bashku me të dëmtuarit - dëshmitarët e tjerë përmes GPRS dhe nuk i ka ndihmuar askush. Fillimisht ka kontaktuar me një shok të tij me emrin Nizar i cili ka qenë në kapin e Magurës në Kosovës dhe i kanë thënë që jemi 4 persona dy prej tyre janë të sëmurë - invalid dhe që të na dërgoj një taksit për me na marrë. Para se me ardh tek kufiri kanë komunikuar në gjuhën angleze me të akuzuarin F., komunikimin e ka bërë S ku edhe janë marrë vesh për çmimin e transportit prej 80 euro mirëpo nuk i kanë paguar paratë pasi që janë zënë nga ana policisë. Me tutje ka theksuar se me të akuzuarin kanë komunikuar në telefon. Qëllimin e ka pasur që përmes Kosovës të kaloj në Itali.

Duke analizuar dëshminë e të dëmtuarit dhënë në cilësi të dëshmitarit, gjykata nuk ka mundur të vërtetojë asnjë element të veprës penale, ku dëshmitari e ka përshkruar se si ka ardhur me autobus deri në pikën kufitare dhe përmes GPRS është orientuar dhe nëpër malë ka hy në Kosovë. Pra, me këtë dëshmi rezulton se i akuzuari nuk ka ndërmarr asnjë veprim lidhur me kalimin e kufirit, dëshmitari vetë ka ardhur në Kosovë pa ndihmën e askujt. Nga pika kufitare i akuzuari në cilësi të taksistit ka pasur për obligim të dërgojë deri tek qendra e azilit – kampi i refugjatëve. Pra, me këtë dëshmi kjo gjykatë nuk ka mundur ta vërtetojë asnjë element të veprës penale me të cilën ngarkohet i akuzuari.

Poashtu gjatë shqyrtimit gjyqësor është lexuar edhe deklarami i të dëmtuarit - dëshmitarit M.K., e cila deklarat është siguruar përmes mundësisë hetuese të veçantë, gjatë dëshmisë së tij ka theksuar se nga Tirana deri në Kukës kanë arritur me autobus më pas kanë vazhduar në këmbë nëpër mal deri në kufi të Kosovës. Më pas janë orientuar përmes personave tjetër që kanë kaluar para tyre. Me të akuzuarin F. M., ka kontaktuar shoku S dhe shoku tjetër që është i operuar dhe e kanë kërkuar një taksi për shkak të gjendjes së atij shokut. Numrin e telefonit e kanë siguruar shoku i tij N. nërëpëmjet N. dhe me telefon e ka thirr N., e pastaj ka komunikuar me të S pasi që ai di të komunikoj në gjuhën angleze.

Duke analizuar dëshminë e të dëmtuarit dhënë në cilësi të dëshmitarit, gjykata nuk ka mundur të vërtetojë asnjë element të veprës penale, ku dëshmitari e ka përshkruar se si ka ardhur me autobus deri në pikën kufitare dhe përmes GPRS është orientuar dhe nëpër malë ka hy në Kosovë. Pra, me këtë dëshmi rezulton se i akuzuari nuk ka ndërmarr asnjë veprim lidhur me kalimin e kufirit, dëshmitari vetë ka ardhur në Kosovë pa ndihmën e askujt. Nga pika kufitare i akuzuari në cilësi të taksistit ka pasur për obligim të dërgojë deri tek qendra e azilit – kampi i refugjatëve. Pra, me këtë dëshmi kjo gjykatë nuk ka mundur ta vërtetojë asnjë element të veprës penale me të cilën ngarkohet i akuzuari.

Gjithashtu gjatë shqyrtimit gjyqësor është lexuar edhe deklarami i të dëmtuarit - dëshmitarit A.L., e cila deklarat është siguruar përmes mundësisë hetuese të veçantë, i cili në dëshminë e tij thekson se deri në Kukës kanë ardh me autobus pastaj në këmbë kanë ecur nëpër mal deri në kufi dhe se nuk i ka ndihmuar askush. Me të akuzuarin kanë komunikuar përmes një shokut të tyre që quhet N dhe i kemi tregu që jemi të sëmure dhe kemi nevojë për taksi për shkak se ka qenë i sëmure dhe i operuar. Me të akuzuarin kanë komunikuar në gjuhën angleze ndërsa ka mohuar që me të njëjtin të kenë bërë marrveshje për çmimin e transportit.

Duke analizuar dëshminë e të dëmtuarit dhënë në cilësi të dëshmitarit, gjykata nuk ka mundur të vërtetojë asnjë element të veprës penale, ku dëshmitari e ka përshkruar se si ka ardhur me autobus deri në pikën kufitare dhe përmes GPRS është orientuar dhe nëpër malë kan hy në Kosovë. Pra, me këtë dëshmi rezulton se i akuzuari nuk ka ndërmarr asnjë veprim lidhur me kalimin e kufirit, dëshmitari vetë ka ardhur në Kosovë pa ndihmën e askujt. Nga pika kufitare i akuzuari në cilësi të taksistit ka pasur për obligim të dërgojë deri tek qendra e azilit – kampi i refugjatëve.

Pra, me këtë dëshmi kjo gjykatë nuk ka mundur ta vërtetojë asnjë element të veprës penale me të cilën ngarkohet i akuzuari.

Nga leximi i raportit të ekspertizës i Drejtorisë Kriminalistike - sektori për fotografi, video analizë dhe ekzaminimeve të IT- Njësia për ekzaminimin e pajisjes të Teknologjisë së Informacionit, është konstatuar se me këtë raport ju njoftojmë se është zbatuar urdhëresa me numër PP/I.nr.4/20 e datës 09.01.2020, lëshuar nga Gjykata Themelore në Prizren-Departamenti i Krimeve të Rënda, lidhur me ekspertimin telefonit „Samsung“, me IMEI:1:...../09/554541/06 dhe IMEI:...../09/554541/04 dhe sim kartelës,, Z - ....." me nr. ...., të cilat janë sekuestruar në çështjen penale kundër të pandehurit F. M., nën dyshim të kryerjes së veprës penale Kontrabandim me migrantë dhe në lidhmëni me rastin 2020-YWC-001.

Me datë 12.02.2020, nga Drejtoria e Teknikës Kriminalistike në Prishtinë, kemi pranuar raportin e ekspertizës prej katër (4) faqeve të shkruara dhe të dhënat elektronike të shkarkuara gjithsejtë në tri CD. Nga shikimi i të dhënave elektronike, janë evidentuar disa mesazhe të shkruara përmes rrjeteve sociale dhe disa foto. Në këto mesazhe kanë rezultuar bisedat e të dëmtuarëve dhe të akuzuarit, i cili ka biseduar në cilësi të taksistit dhe për vend takimin se ku duhet ti merr. Pra, me këtë provë nuk është vërtetuar asnjë fakt inkriminues.

Me datën 7/1/2020, të akuzuarin F. M., në ora 07:55 PM (pasdite) e ka kontaktuar përmes rrjetit social .....@s.whatsapp.net nassimboughanem, me të cilin ka bisedë të evidentuar (nuk dihet përmbajtja), i cili pastaj i ka dërguar edhe lokacionin se ku gjendet, e që ka rezultuar se ka qenë te Liqeni i Vërmicës, ku edhe është evidentuar në hartë në koordinatat "Vrbnica" (foto mesazhet e dërguara të datës 7/1/2020). Nuk është kontestuese se i akuzuari në cilësi të taksistit ka shkuar që ti merr të dëmtuarit në fshatin Vërmicë afër kufirit. Pra, me këtë provë nuk është vërtetuar asnjë fakt inkriminues.

Me datën 7/1/2020, i njëjti person ka të regjistruara disa kontakte (thirrje, SMS) me të akuzuarin F. M., përmes rrjetit whatsapp nga llogaria 9053438588670s.whatsapp.net. Poashtu me datën 7/1/2020, në ora 11:48:17 PM, përmes rrjetit social whatsapp", personi me mbishkrimin në gjuhë arabe dhe me numrin ....., i cili i ka dërguar mesazh të akuzuarit F.: Paqja qoftë mbi ju. Kam 14 persona që duan të shkojnë në Kosovë, a mundem? Me datën 8/1/2020, i akuzuari F. M., është thirrur edhe nga një person tjetër përmes llogarisë 905342422601@s.whatsapp dhe mbishkrimi në gjuhën arabe, koha 11:44:54 PM. Nuk është kontestues fakti se i akuzuari ka kontaktuar me persona bërë bartjen me taksit, por i njëjti nuk ka qenë në dijeni se në çfarë mënyre ata kanë hyrë në Kosovë apo të ketë kontribuar për hyrjen e tyre në Kosovë në mënyrë jo të rregullt. Ndërsa sa i përket bartjes i njëjti është taksist dhe e ka këtë profesion për bartjen e njerzve. Pra, me këtë provë nuk është vërtetuar asnjë fakt inkriminues.

Me datën 8/1/2020, në llogarinë e të akuzuarit F. M., është regjistruar edhe një SMS, kohë 09:51:09, i dërguar nga personi Mumin, .....@whatsapp.net, siç është shkruar: Vella, si je? Dua të shkoj në kufirin serb. A më telefonove kur të kesh mbaruar? Nga këto të dhëna kuptohet se i akuzuari F. M., ka pasur kërkesa të shumta

për transportin e shtetasve të huaj për datat 7 dhe 8 Janar 2020. Nuk është kontestues fakti se i akuzuari ka bërë bartjen e personave si taksist në gjithë territorin e Kosovës, por nuk është vërtetuar asnjë fakt se i njëjti ka kontribuar për kalimin ilegal të kufirit të personave që i ka bartur si taksist. Pra, me këtë provë nuk është vërtetuar asnjë fakt inkriminues.

Nga shqimi në fotodokumentacion, shihen pamjet e viktimave apo të dëmtuarëve si dhe dokumentet personale të akuzuarit. Nuk është kontestuese se ditën kritike personat janë fotografuar duke u transportuar nga i akuzuari. Pra, me këtë provë nuk është vërtetuar asnjë fakt inkriminues.

Nga leximi i vëretimit mbi sekustrimin e përkohshëm me nr. 2020-YWC-001 të datës 07.01.2020, vëretohet fakti se janë sekuestruar vetura dhe telefoni Samsung, e më pastaj telefoni i është kthyer të akuzuarit. Nuk është kontestuese se ditën kritike është sekuestruar vetura dhe telefoni i të akuzuarit. Pra, me këtë provë nuk është vërtetuar asnjë fakt inkriminues.

I akuzuari në mbrojtjen e tij të dhënë në shqyrtim gjyqësor ka deklaruar se qëndron në tërësi pranë deklarimit të dhënë në Prokurori me datën 08.01.2020. E ka pohuar faktin se vetura e markës '.....' me targa ..... është në pronësi të tij. Më tutje në deklarimin e tij ka theksuar se pasi që ka marrë telefonatë nga emigrantët ai është nisur prej Prishtinës në drejtim të Prizrenit pasi që të njëjtit ia kanë dërguar lokacionin përmes GPRS dhe pasi që është bindur që ata janë në territorin e Republikës së Kosovës, janë nisur në drejtim të Prizrenit – lokacionit dhe kur ka ardhur aty i ka marrë dhe ka vazhduar rrugën më pas gjipi i policisë i është lëshuar mbrapa dhe e kanë ndaluar deri sa e ka kaluar urën. Në vazhdim të mbrojtjes thekson se e ka ditur se është duke bartur emigrantë por se ka ditur që nuk kanë dokumentacion. Ka mohur që në ditën kritike të ketë kaluar kufirin apo të ketë pas ndonjë marrëveshje me ndonjë person tjetër nga ana tjetër e kufirit për transportimin e emigrantëve.

Duke analizuar mbrojtjen e të akuzuarit, gjykata nuk ka vërtetuar asnjë fakt inkriminues, pasi që kjo mbrojtje është në harmoni me të gjitha provat e administruara, i akuzuari ushtron veprimtarinë e taksistit dhe se ditën kritike ka shkuar që ti merr të dëmtuarit në fshatin Vermicë të Prizrenit, pasi që të njëjtit e kanë kontaktuar dhe për mes lokacionit ia kanë dërguar vendodhjen e tyre.

Gjykata duke i analizuar me kujdes të gjitha provat e administruara e të cilat janë elaboruar veç e veç, dhe duke i ndërlidhur sëbashku nuk është vërtetuar se i akuzuari në afërsi të restorant "Jeta" në fshatin Vermicë, Komuna e Prizrenit, është hasur nga ana e Policisë se merret me kontrabandim të migranteve e me qëllim të përfitimit të drejtperdrejte të dobisë pasurore, në atë mënyrë që gjatë patrullimit të Policisë Kufitare, Policia ka ndaluar automjetin ".....", me targa ....., të cilën ishte duke e drejtuar i akuzuari F. M., dhe është vërtetuar se i akuzuari transporton migrantët palestinez S.O.S., M.A., N.L., dhe A.L., të cilët ka pasur ti transportojë pas marrëveshjes paraprake prej pikës kufitare Vermicë në qendrën e azilit për të huaj në Magurë, dhe për këtë shërbim nga secili prej tyre është dashur ti merr nga 20 euro. Pra, deri në përfundim kjo gjykatë ka ardhur me dëgjimin e të dëmtuarëve në cilësi të

dëshmitarëve, të cilët njëzëri kanë theksuar se kanë biseduar me një person i kombësisë së tyre dhe nga ai e kanë marrë numrin e të akuzuarit, me të cilin kanë komunikuar në gjuhën angleze pasi që kanë hyrë në teritorin e Republikës së Kosovës. Secili nga ta ka theksuar se për të ardhur për në Republikën e Kosovës kanë udhëtuar përmes Tiranës me autobus deri afër kufirit më pas nëpër mal kanë hec rreth 4 km dhe pastaj kanë zbritur në rrugë dhe janë orientuar përmes GPRS. Gjatë kalimit të kufirit nuk i ka ndihmuar askush apo ti ketë udhëzuar ndokush. Pra, me këto dëshmi nuk është vërtetuar asnjë element inkriminues për të akuzuarin. Nga administrimi i provave materiale nuk është kontestues fakti se i akuzuari ka kontaktuar përmes rjetit "Whatsaap" në gjuhën angleze dhe nga ta ka pranuar lokacionin për të shkuar dhe për ti transportuar nga fshati Vërmicë, Komuna e Prizrenit, për në Qendrën e Azilit në fshatin Magure. I njëjti me profesion është taksist dhe meret me këtë punë që disa vite dhe se detyra e tij është transporti i personave. Pra, duke i analizuar me kujdes elementet e veprës penale kontrabandim me migrantë të paraparë në nenin 164 të KPRK-së, rezulton se për të ekzistuar kjo veprë penale domosdo duhet të jetë " çdo veprim me qëllim të përfitimit të drejtëpërdrejtë ose të tërthortë të një dobie financiare ose të ndonjë dobie tjetër pasurore nga hyrja e paligjshme e personit në Republikën e Kosovës, i cili nuk është shtetas i Republikës së Kosovës ose i një personi qoftë shtetas i Republikës së Kosovës apo shtetas i huaj në shtetin në të cilin personi i tillë nuk është banorë i përhershëm ose shtetas i atij shteti". Në rastin konkret nuk e kemi elementin qenësor të kësaj veprë penale që i akuzuari të ketë lidhje me kalimin e kufirit për të dëmtuarit. I akuzuari ka transportuar të njëjtit brenda teritorit të Republikës së Kosovës, pa qenë në dijeni apo pa dhënë kurrfar instruksioni apo ndihme se si kan hyrë ata në teritorin e Republikës së Kosovës. Fakti tjetër është edhe shuma e çmimit të kërkuar, i njëjti ka kërkuar çmimin e tregut se si vepron si taksist në teritorin e Republikës së Kosovës, shuma e kërkuar nuk i kalon limitet e tregut, për çka te rastetet me migrantë shuma e çmimit të transportit kërkohet një shumë bukur më e lartë se çmimi i tregut. Nga të gjitha të lartcekurat, kjo gjykatë ka ardhur në përfundim se nuk formohen elementet e veprës penale të kontrabandimit me migrantë nga neni 164 parag. 1 të KPRK-së dhe në mungesë të provave i akuzuari është liruar nga aktakuza.

Kjo gjykatë në kuptim të nenit 3 parag. 2 të KPP-së, mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të të akuzuarit dhe të drejtave të tij sipas këtij Kodi dhe sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Në rastin konkret mëdyshjet sipas kësaj dispozite janë interpretuar në favor të të akuzuarit.

Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat dhe provat të cilat u administruan nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprën penale që i vihet në barrë me aktakuzë, prandaj i njëjtit lirohet nga akuza.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë konform nenit 453 paragrafi 1 të KPP-së.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## **GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**



**DEPARTAMENTI PËR KRIMET E RËNDA**  
**Pkr.nr.63/2023 datë 09.02.2024**

**Procesmbajtësja,**  
**Floriqe Kolukaj**

**Kryetari i trupit gjykues,**  
**Artan Sejrani**

**UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi lejohet ankesa në afat prej pesëmbëdhjetë (30) ditëve nga dita e pranimit, Gjykatës e Apelit e Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.